



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Letër Rekomandim

Ex Officio 257/2020

Institucioni i Avokatit të Popullit

kundër

Ministrisë së Infrastrukturës

Komunikimi në këtë rast është zhvilluar nëpërmjet postës elektronike për arsye të ndërmarrjes së masave më të shpejta lidhur me çështjen. Letra me Rekomandime e Avokatit të Popullit, i është drejtuar Zëvendës ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit më 1 prill 2020, nëpërmjet përfaqësueses së Avokatit të Popullit.

(Teksti origjinal i korrespondencës elektronike)

I nderuar Zëvendësministër,

Më lejoni që fillimisht në emër të Avokatit të Popullit të ju falënderoj për angazhimin e ministrisë në mirë administrimin e situatave të paplanifikuara në periudhën e pandemisë, e në veçanti të organizimit të procesit të vajtje-ardhjes nëpërmjet linjave të veçanta ajrore dhe tokësore, në vend dhe anasjelltas, të qytetarëve tonë dhe të tjerëve.

Në këtë drejtim Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të mandatit kushtetues dhe ligjor, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ka përcjellur procesin e kthimit të qytetarëve nga vendet tjera.

Edhe pse të vetëdijshëm lidhur me vështirësitë e hasura nga institucionet për menaxhimin e procesit të organizimit të kthimit të qytetarëve në vend gjatë kësaj situate, nëpërmjet këtij emaili do të donim të ngrisim shqetësimet e adresuara nga qytetarët e kthyer për kufizimin e mundshëm të të drejtave të njeriut, pas arritjes së tyre në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Shqetësimi i qytetarëve të kthyer nga jashtë vendit, i ngritur në Institucionin e Avokatit të Popullit, është fotografimi i të tyre në hollin e aeroportit veç e veç, pa marrjen e pëlqimit të tyre, pa e bërë të ditur arsyen e fotografimit. Shqetësim në vete është publikimi i fotove në faqen e facebook-ut të Ministrisë së Infrastrukturës, pa asnjë masë e cila do të pamundësonte identifikimin e tyre.

Duke qenë të vetëdijshëm për mbingarkesën e institucioneve gjatë organizimit të procesit të hyrjes së qytetarëve në vend, mungesën e përvojës së stafit në këtë drejtim dhe interesin e publikut për t’u informuar, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të

është

drejtës së privatësisë, dhe me qëllim të evitimit të lëshimeve të paqëllimta të administrimit të procesit, gjithnjë duke pasur parasysh që të drejtat e njeriut nuk mund të jenë dytësore, edhe në situatë pandemie, Ju rekomandojmë:

- që në situata të njëjta dhe të ngjashme, zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Infrastrukturës, të prezantojnë qëllimin e fotografimit; dhe po ashtu,
- me rastin e publikimit të fotove të mëtohet të mbrohet identiteti i qytetarëve.

Mbesim në pritje të përgjigjes suaj, lidhur me masat që do të ndërmerri në drejtim të zbatimit të rekomandimeve dhe me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve për të cilin jemi të bindur se është qëllimi i yni i përbashkët.

Kopja e letrës t'i përcillet Ministrit të Infrastrukturës dhe Ambientit dhe zyrtarëve tjerë përgjegjës.